



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE  
AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE**

## **PLANI I PUNËS**

**VITI 2025**

**DETAJUAR SIPAS DREJTORIVE TË AIF**

---

## **I. DREJTORIA E PËRPUTHSHMËRISË**

### **PLANI I PUNËS**

#### **JANAR – DHJETOR 2025**

Nëpërmjet këtij plani vjetor, Drejtoria e Përputhshmërisë, përcakton objektivat kryesorë të aktivitetit të saj për vitin 2025, të shoqëruar me masat, afatet dhe treguesit konkret që do të ndërmerren në funksion të realizimit të tyre.

Në procesin e hartimit të këtij plani janë marrë në konsideratë çështjet të cilat përbëjnë prioritet për veprimtarinë e drejtorisë, vlerësimi i kategorive të subjekteve të ligjit PPP/FT me rëndësi të veçantë për procesin e përputhshmërisë, rritja e nivelit të bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse dhe liçensuese, koordinimin e punës me strukturat e AIF, angazhimin në plotësimin e detyrimeve që lidhen me procesin e vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, pjesëmarrja aktive në projektet ndërkombëtare që ofrojnë asistencën për institucionet Shqiptare, Kontributi për hartimin e raportit vjetor të AIF për vitin 2024, zhvillimet për databazën e subjekteve raportuese, rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Drejtorisë nëpërmjet njohjes dhe zbatimit të praktikave ndërkombëtare. Plani vjetor i punës, mund të jetë objekt rishikimi në përputhje me çështje të tjera prioritare që mund të diktohen nga dinamika e aktivitetit të institucionit.

Puna e Drejtorisë së Përputhshmërisë gjatë vitit 2025, do të përqëndrohet në rritjen e mëtejshme të efektivitetit të sistemit parandalues, forcimit të bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse, ofrimin e mbështetjes për sektorin privat dhe zbatimit të rekomandimeve të Komitetit Moneyval të KiE, FATF dhe organizmave të tjerë ndërkombëtar.

Realizimi i objektivave dhe masave të këtij programi, do të sigurohet në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë me Drejtorinë e Analizës, Drejtorinë e Kordinimit dhe Juridike dhe Drejtorinë e TI. Një aspekt i rëndësishëm në funksion të forcimit të mëtejshëm të sistemit parandalues në vend, do të jetë edhe realizimi i trajnimeve të vazhdueshme me synimin e rritjes së kapaciteteve të subjekteve raportuese në përputhje me rreziqet PP/FT, me të cilat përballen sektorë të caktuar dhe marrja e masave për zvogëlimin e këtyre rreziqeve. Përveç inspektimeve në vend, në distancë do të kërkojë edhe organizimin e trajnimeve dhe takimeve gjë për të cilën do të përdoren sa më efektivisht të jetë e mundur burimet e Drejtorisë, bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse, shoqatat e subjekteve si dhe mbështetja e vazhdueshme që ofrohet nga projektet ndërkombëtare (FSVC, KiE, GIZ etj).

Bazuar në përvojën që është përftuar në vitet e mëparshme, bashkëpunimi me Autoritetet Mbikëqyrëse në drejtim të inspektimeve të përbashkëta dhe mbështetjes për rritjen e kapaciteteve parandaluese të subjekteve të ligjit, do të vijojë të jetë një ndër objektivat kryesorë të drejtorisë.

Më anë të planifikimit të inspektimeve në vend dhe në distancë të subjekteve të ligjit, synohet evidentimi i mangësive në zbatimin e legjislacionit PPP/FT, konstatimin dhe evidentimin e shkeljeve ligjore, rritjen e nivelit të raportimit, dhënien e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme të punës së subjekteve raportuese si dhe asistencë teknike në funksion të përdorimit të moduleve të TI.

Procesi i analizimit të përputhshmërisë së subjekteve do të bazohet në kategorizimin e rrezikut të tyre, sasisë dhe cilësisë së informacionit që ato disponojnë, raportimet e bëra prej tyre si dhe informacionit të marrë nga strukturat brenda AIF apo autoritetet mbikëqyrëse.

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet programi i punës i Drejtorisë së Përputhshmërisë, për vitin 2025, me objektivat, masat afatet, treguesit e vlerësimit dhe strukturat përgjegjëse.

<b>Nr .</b>	<b>OBJEKTIVA T</b>	<b>MASAT</b>	<b>AFATI</b>	<b>TREGUES TË VLERËSIMIT</b>	<b>STRUKTURA</b>
1.	Analiza e punës së Drejtorisë së Përputhshmërisë për vitin 2025.	– Hartimi i analizës vjetore të punës së Drejtorisë;	20 Janar 2025	– Përcaktimi i objektivave për periudhën në vazhdim;	Drejtoria e Përputhshmërisë
2.	Raporti Vjetor 2024.	– Përgatitja e materialit të Drejtorisë sipas rubrikave përkatëse të Raportit Vjetor;	30 Janar 2025	– Dorëzimi i materialit për grupin e punës për hartimin e raportit vjetor 2024;	Drejtoria e Përputhshmërisë
3.	Analiza e Përputhshmërisë së subjekteve.	– Përzgjedhja e subjekteve dhe përgatitja e programeve të punës për inspektimet në vend dhe në distancë sipas kategorizimit të riskut PP/FT;	Në baza mujore gjatë vitit	– Përgatitja dhe paraqitja e planeve mujore të përputhshmërisë;	Sektori i Inspektimit Sektori i Përputhshmërisë
		– Shqyrtimi i vlerësimeve të marra nga strukturat e AIF; – Rishikimi i manualit të përputhshmërisë dhe vlerësimit të riskut të subjekteve; – Zbatimi i procedurave standarte të përputhshmërisë;	Në baza tremujor e gjatë vitit	– Analiza periodike e ecurisë së përputhshmërisë;	

4.	Analizimi tematik i nivelit të përputhshmërisë së subjekteve financiare.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizimi i masave të marra për personat e shpallur dhe rezolutave të KS të OKB;</li> <li>- Vlerësimi i rreziqeve dhe përcaktimi i masave për zvogëlimin e tyre;</li> <li>- Kontrolli i brendshëm dhe masat për PPP/FT;</li> </ul>	Gjatë vitit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e planeve të përputhshmërisë;</li> <li>- Hartimi i raporteve përfundimtare;</li> </ul>	Drejtoria e Përputhshmërisë
5.	Trajnimi i subjekteve të ligjit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i një plani për trajnimet e subjekteve;</li> <li>- Organizimi i trajnimeve për subjektet raportuese mbi bazën e nevojave të evidentuara në planin e integruar të GTNP;</li> <li>- Komunikimi me autoritetet mbikëqyrëse për koordinimin e aktiviteteve trajnuese;</li> <li>- Përditësimi i materialeve të trajnimit në varësi të përzgjedhjes të subjektit për trajnim, duke pasur në konsideratë zbatimin e udhëzimit mbi sanksionet ndërkombëtare dhe gjetjet e vlerësimit kombëtar të riskut PP/FT (NRA);</li> <li>- Njohja me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe integrimi i tyre në procesin e trajnimeve;</li> <li>- Rishikimi dhe publikimi i tipologjive dhe treguesve të PP/FT në nivel vëndas ose ndërkombëtar dhe</li> </ul>	20 Janar 2025  Gjatë vitit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e planit;</li> <li>- Numri i subjekteve/personave të trajnuar;</li> <li>- Mbajtja e evidencave për secilin trajnim;</li> <li>- Përgatitja e raporteve periodike lidhur me subjektet dhe personat e trajnuar;</li> <li>- Dhënia e certifikatave për pjesëmarrjen në trajnim;</li> </ul>	Drejtoria e Përputhshmërisë

		<p>përfshirja e tyre në modulet e trajnimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrje aktive në aktivitete që ofrohen në kuadrin e projekteve ndërkombëtare në të cilat AIF është institucion vlerësues (KiE, FSVC etj.);</li> </ul>			
6.	<p>Analizimi tematik i nivelit të përputhshmërisë të profesioneve të lira jo-financiare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizimi i masave të marra për personat e shpallur dhe rezolutave të KS të OKB;</li> <li>- Vlerësimi i rreziqeve dhe përcaktimi i masave për zvogëlimin e tyre;</li> <li>- Kontrolli i brendshëm dhe masat për PPP/FT, për ato raste kur mund të ketë.</li> <li>- Rishikimi i vlerësimit të riskut PP/FT të subjekteve të ligjit;</li> </ul>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Dhjetor 2025</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e planeve të përputhshmërisë;</li> <li>- Hartimi i raporteve përfundimtare;</li> <li>- Vlerësimi i rishikuar;</li> </ul>	<p>Spektori i Inspektimit dhe Spektori i Mbikëqyrjes</p>
7.	<p>Plani i inspektimeve në vënd dhe në distancë</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bankat</li> </ul>	<p>Shkurt</p> <p>Prill</p> <p>Shtator</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportet e Inspektimit në vënd</li> </ul>	<p>Spektori i Inspektimit</p>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shoqëritë e ndërtimit</li> </ul>	<p>Gjatë vitit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportet e Inspektimit në vënd dhe në distancë</li> </ul>	<p>Spektori i Inspektimit dhe Spektori i Mbikëqyrjes</p>

		- Noteret	Gjatë vitit	- Raportet e Inspektimit në vënd dhe në distancë	Sektori i Inspektimit dhe Sektori i Mbikëqyrjes
		- Institucione financiare- Jo bankë	Mars, Prill Shtator, Tetor	- Raportet e Inspektimit në vënd dhe në distancë	Sektori i Inspektimit dhe Sektori i Mbikëqyrjes
		- Ndërmjetës të pasurive të paluejtshme	Gjatë vitit	- Raportet e Inspektimit në vënd dhe në distancë	Sektori i Inspektimit dhe Sektori i Mbikëqyrjes
		- Shoqëri komisionere	Maj - Dhjetor	- Raportet e Inspektimit në vënd dhe në distancë	Sektori i Inspektimit dhe Sektori i Mbikëqyrjes
		- Institucione të parasë elektronike dhe të shërbimeve të pagesave	Maj - Dhjetor	- Raportet e Inspektimit në vënd dhe në distancë	Drejtoria e Përputhshmërisë
8.	Mbikëqyrja e subjekteve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi (në vënd/në distancë) i subjekteve në përputhje me nivelin e kategorizimit të riskut PP/FT;</li> <li>- Verifikimi i nivelit të përmbushjes së detyrimeve ligjore;</li> <li>- Përcaktimi i rekomandimeve për mangësitë e konstatuara;</li> <li>- Ndjekja e rekomandimeve për subjektet raportuese;</li> <li>- Dërgimi, analizimi, verifikimi dhe kontrolli i RVK për subjektet e ligjit;</li> <li>- Shkëmbimi i informacionit brenda AIF;</li> </ul>	Gjatë vitit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i inspektimeve të subjekteve të ligjit;</li> <li>- Numri i RAD të dërguara;</li> <li>- Niveli i ndërgjegjësimit të subjekteve;</li> <li>- Konkluzione mbi zbatimin e rekomandimeve;</li> </ul>	Drejtoria e Përputhshmërisë

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ofrimi i asistencës nga Grupi i Inspektimit në kuadër të kuptimit të kuadrit ligjor rregullativ dhe përmirësimit të punës në vijim nga ana e subjekteve me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe rritjen e cilësisë së raportimeve;</li> <li>- Vlerësimi i praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes dhe përfshirjen e tyre në procesin e inspektimeve në vend dhe distancë;</li> </ul>			
9.	Komunikimi me autoritetet Mbikëqyrëse dhe Licencuese.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e konkluzioneve për përputhshmërinë e subjekteve gjatë 2023 dhe dërgimi i tyre për Autoritetet Mbikëqyrëse dhe Licencuese;</li> <li>- Takime me shoqatat përfaqësuese të subjekteve kryesore raportuese të RAD (shoqata e bankave, DHKN)</li> </ul>	15 Shkurt 2025	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dërgimi i shkresave;</li> <li>- Informacion mbi takimet;</li> </ul>	Drejtoria e Përputhshmërisë
		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizimi i përputhshmërisë me Autoritetet Mbikëqyrëse Licencuese;</li> <li>- Realizimi i takimeve në baza periodike;</li> <li>- Shkëmbimi i praktikave më të mira të inspektimit;</li> </ul>	Gjatë vitit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Informacion mbi takimet periodike;</li> <li>- Raport mbi inspektimet e përbashkëta;</li> </ul>	
10.	Bashkërendimi i planeve të punës me autoritetet mbikëqyrëse.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikimi me autoritetet mbikëqyrëse/licencuese për inspektimet e përbashkëta;</li> </ul>	Gjatë vitit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i memove me informacionin dhe konkluzionet përkatëse;</li> </ul>	Drejtoria e Përputhshmërisë

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunimi në drejtim të rritjes së kapaciteteve parandaluese;</li> <li>- Vlerësimi i funksionimit të MoU me autoritetet mbikëqyrëse/licencuese;</li> </ul>			
11.	Forcimi i bashkëpunimit me subjektet raportuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Takime me personat përgjegjës të PP/FT të subjekteve banka dhe shoqërive të trasfertave;</li> <li>- Njohja me praktikën e punës së disa bankave të nivelit të dytë, njësisive PPP/FT</li> </ul>	Gjatë vitit	- Informacion mbi takimet	Drejtoria e Përputhshmërisë
12.	Kontributi për takimet apo raportet kombëtare dhe ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjetjet për rezultatet imediate IO.3, IO.9, IO.10 dhe IO.11;</li> <li>- Takimet e grupit teknik ndërinstytucional;</li> </ul>	20 Janar 2025  Gjatë vitit	- Hartimi dhe dërgimi i raporteve;	Drejtoria e Përputhshmërisë



---

## DREJTORIA E ANALIZËS FINANCIARE

Funksioni themelor Drejtorisë së Analizës Financiare (DAF), është mbledhja e raporteve të aktivitetit të dyshimtë (RAD) apo të dhënave të tjera të ngjashme<sup>1</sup>, analizimi i tyre, marrja e informacioneve shtesë nëse nevojiten, duke konkluduar me raste të dyshimta që shpërndahen në organet e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës.

Përveç sa më sipër, DAF:

- Koordinon, ndjek si dhe harton dokumentet përkatës të vlerësimit kombëtar të riskut;
- Harton analiza sektoriale sipas fushës së veprimtarisë;
- Kthen përgjigje për kërkesat që kalohen për trajtim për organe të ndryshme apo homolog;
- Kontribuon në kuadër të plotësimit të standardeve/kërkesave si rrjedhojë e proceseve të monitorimit nga Moneyval/ICRG;
- Kontribuon në ndjekjen e strategjive ndër-institucionale që lidhet edhe me funksionet e AIF;
- Kryen plotësim pyetësorësh, reagime ndaj kërkesave për informacion nga publiku/media;
- Ndjek projekte për pjesën takuese të DAF;
- Detyra të tjera sipas rastit.

Programi vjetor i punës për DAF për periudhën Janar-Dhjetor 2025, paraqitur në tabelën e mëposhtme përcakton objektivat kryesorë të aktivitetit të saj të shoqëruar me masat, afatet dhe treguesit konkret të realizimit të tyre dhe strukturat përgjegjëse.

### PLANI I PUNËS

#### JANAR – DHJETOR 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	MASAT	AFATI	TREGUES TË VLERËSIMIT	STRUKTURA
1.	Vlerësimi i RAD dhe praktikave të ardhura.	<ul style="list-style-type: none"><li>- Analizim të informacionit të marrë;</li><li>- Vlerësim i rasteve të trajtuara;</li></ul>	Gjatë vitit	- Vlerësimi i rreth 1600 RAD/Praktikave në vit.	Spektori I Investigimit  Spektori i Analizës Paraprake të Rasteve të Dyshimta Spektori i FINTECH dhe Sanksioneve Ndërkombëtare
2.	Dërgim të informacioneve për raste të dyshuara për PP/FT në organet ligj	<ul style="list-style-type: none"><li>- Shpërndarje të RAD të ardhura;</li><li>- Analizim të informacionit të marrë;</li></ul>	Gjatë vitit	- Pritshmëria peer dërgim të rreth 200-220 rasteve në organet me të	Spektori I Investigimit

<sup>1</sup> Si informacion spontane nga homolog apo nga burime të tjera.

	zbatuese dhe të inteligjencës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i kërkesave shtesë;</li> <li>- Konkludimi dhe dërgim informacioni.</li> </ul>		cilat bashkëpunojmë;	<p>Sektori i Analizës Paraprake të Rasteve të Dyshimta</p> <p>Sektori i FINTECH dhe Sanksioneve Ndërkombëtare</p>
3.	Trajtim të kërkesave nga organe të ndryshme apo homolog.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajtimi dhe verifikime në kuadër të kërkesave;</li> <li>- Realizim të kthim përgjigjeve.</li> </ul>	Gjatë vitit	- Numri i përgjigjeve të kthyera	<p>Sektori I Investigimit</p> <p>Sektori i Analizës Paraprake të Rasteve të Dyshimta</p> <p>Sektori i FINTECH dhe Sanksioneve Ndërkombëtare</p> <p>Sektori i Analizës Strategjike</p>
4.	Ndjekja e zbatimit të projekteve ndërkombëtare në të cilat AIF është pjesë si institucion përfitues.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikimi dhe përcjellja e nevojave;</li> <li>- Bashkëpunimi për hartimin e projekteve.</li> </ul>	Gjatë vitit	- Komunikimet dhe kontributet e dhëna.	<p>Sektori I Investigimit</p> <p>Sektori i Analizës Paraprake të Rasteve të Dyshimta</p> <p>Sektori i Analizës Strategjike</p> <p>Sektori i FINTECH dhe Sanksioneve Ndërkombëtare</p>
5.	Trajnimi i punonjësve Drejtorisë së Analizës	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnimi i punonjësve;</li> </ul>	Gjatë vitit	- Vlerësimi i njohurive për programet e ndjekura;	<p>Sektori I Investigimit</p> <p>Sektori i Analizës Paraprake të Rasteve të Dyshimta</p> <p>Sektori i Analizës Strategjike</p> <p>Sektori i FINTECH dhe Sanksioneve Ndërkombëtare</p>
6.	Analizimi i llogarive bankare të anëtarëve të strukturave të ngarkuara me ligj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledhje dhe rakordim me bankat; për përgjigjet e dërguara prej tyre</li> <li>- Analizim të informacionit të dërguar;</li> <li>- Pasqyrimi i të dhënave të rezultuara;</li> </ul>	Gjatë vitit	- Realizimi i një memove përmbledhëse për secilën fazë të konkluduar	DAF

7.	Realizimi analizave sektoriale sipas risqeve të identifikuara	Faza e parë: - Dërgim kërkesash për marrje informacioni ; - Vlerësimi i të dhënave; - Analizimi dhe fokusimi në elementë specifikë.	Janar- Qershor 2025	- Realizimi i një memove finale; - Adresimi i gjetjeve;	Sektori i Analizës Strategjike
		Faza e dytë: -Vijimi i kërkesave në subjekte të tjera - Vlerësimi i të dhënave; - Realizimi i analizës	Qershor - Dhjetor 2025		
8.	Përgatitja e statistikave apo materialeve takuese në kuadër të vlerësimit të ardhshëm të vendit nga Komiteti Moneyval.	- Përpunimi i një përmbledhje për IO1, IO6, IO7 dhe IO 8 - Identifikimi dhe përpunimi i të dhënave të tjera si tipologji, vlefshmëria e informacioneve të përcjella nga AIF (në kuadër të referimeve për PP, kthim përgjigjeve etj. )	Gjatë vitit	- Përgatitja e materialeve përmbledhëse	Sektori i Analizës Strategjike  Sektori I Investigimit  Sektori i Analizës Paraprake të Rasteve të Dyshimta  Sektori i FINTECH dhe Sanksioneve Ndërkombëtare
9.	Koordinimi i ndjekjes së Planit të Veprimit të NRA PP/FT.	- Mbajta e komunikimeve me pikat e kontaktit për secilin institucion të përfshirë; - Dërgimi i shkresave zyrtare; - Mbajtja e takimeve ndërinsticionale.	Gjatë vitit	- Realizimi i një memo përfundimtare për ecurinë	Sektori i Analizës Strategjike
		- Njoftimi për ecurinë faza 1	Prill 2025		
		- Njoftimi për ecurinë faza 2	Gusht 2025		
		- Njoftimi për ecurinë faza 3	Dhjetor 2025		

## **AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE**

### **DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE JURIDIKE**

#### **PLANI I PUNËS**

##### **JANAR – DHJETOR 2025**

Plani vjetor i punës për Drejtorinë e Koordinimit dhe Juridike (DKJ) për vitin 2025 është hartuar në përputhje me objektivat dhe aktivitetet kryesore specifike për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të kësaj drejtorie si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e Agjencisë të Inteligjencës Financiare (AIF).

Në hartimin e këtij plani vjetor pune janë marrë në konsideratë çështjet prioritare të AIF si në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke pasur në fokus të veçantë, parapërgatitjen dhe plotësimin e pyetësorëve për raundin e 6të të vlerësimit nga Moneyval, realizimin e ushtrimeve simuluese për IO1 -4-5-9, rritjen e cilësisë të kapaciteteve dhe përfaqësimit të AIF në kuadër të takimeve bilaterale BE-Shqipëri dhe institucionet si brenda dhe jashtë vendit, ndjekjen e monitorimit të “Strategjisë Kombëtare për PPP/FT”.

Në këtë këndvështrim objektivat e DKJ për periudhën Janar – Dhjetor 2025 do të fokusohet në objektivat/drejtimet kryesore të poshtë evidentuara:

- Ndjekjen e miratimit të projekt-akteve nënligjore të propozuara në zbatim të ligjit 9917/2008 (i ndryshuar) me synim zbatimin e plotë të kuadrit ligjor në fushën e PP/FT nga autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet e ligjit.
- Rritja e cilësisë arsyetuese ligjore të praktikave administrative që shqyrtohen nga Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative me synim konsolidimin dhe unifikimin e vendimmarrjes të AIF.
- Ndjekja e procedurave gjyqësore pranë gjykatave të të gjitha niveleve për çështjet ku AIF është palë në proces.
- Ndjekja e çdo procedure ligjore për ekzekutimin e plotë të masave administrative të formës së prerë.
- Respektimi i afateve dhe normave ligjore në kthim përgjigje për institucionet ligj zbatuese dhe palët e treta.
- Koordinimin dhe ndjekje me institucionet përgjegjëse Shqiptare të përgatitjes dhe plotësimit të pyetësorëve për raundin e 6të të vlerësimit.
- Përgatitja, pjesëmarrja dhe prezantimi në takimet bilaterale në kuadër të kapitujve që AIF është anëtare (kryesisht Kapitulli 4, 23, 24 dhe 31).
- Koordinimi, plotësimi dhe dërgimi brenda afateve të përcaktuara i kërkesave/ pyetësorëve apo projekteve të dërguar nga Moneyval/Egmont apo organizmave të tjerë ndërkombëtar.
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit të Bashkëndimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KKBLPP) dhe asistimit në përgatitjen e materialeve në kuadër të raportimit të AIF.
- Ndjekja e detyrave të miratuar nga Komitetit të Bashkëndimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KKBLPP) nëpërmjet koordinimit të institucional.
- Ndjekja e monitorimit të “Strategjisë Kombëtare të PPP/FT” dhe koordinim ndërinstitutional.
- Rritja e cilësisë dhe efektivitetit në kthimin e përgjigjeve për institucionet ligj zbatuese Shqiptare, organizmat ndërkombëtare dhe Njësitë homologe të Inteligjencës Financiare.
- Ndjekja e zhvillimeve të Grupit EGMONT, Komitetit MONEYVAL të KE dhe praktikat më të mira të FATF.
- Mbarëvajtja e korrespondencës elektronike të AIF me institucionet e tjera ligj zbatuese, palët e treta dhe publikun.

- Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të DKJ nëpërmjet ndjekjes së takimeve të punës/ trajnimeve/ aktiviteteve/ konferencave sipas fushës së veprimtarisë si brenda dhe jashtë vendit.

Realizimi i objektivave dhe masave të këtij plani do të mundësohet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me strukturat përbërëse të AIF përkatësisht Drejtorinë e Analizës Financiare, Drejtorinë e Përputhshmërisë, Drejtorinë e Teknologjisë të Informacionit dhe Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjithashtu me qëllim realizimin sa më cilësor të këtij plani pune DKJ do të fokusohet në rritjen e kapaciteteve të stafit të kësaj Drejtorie si dhe përfshirjen e tyre në takime, trajnime, grupe pune në këtë drejtim.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet plani i punës për periudhën Janar – Dhjetor 2025 për DKJ me objektivat, masat, afatet, treguesit e vlerësimit dhe strukturat përgjegjëse.

### PLANI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	MASAT	AFATI	TREGUES TË VLERËSIMIT	STRUKTURA
1.	Ndjekja e miratimit të projekt-akteve nënligjore të propozuara në zbatim të ligjit 9917/2008 (i ndryshuar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndjekja e miratimit nga MFE të projekt udhëzimeve për institucionet financiare (banka dhe jo-banka) dhe bizneseve dhe profesioneve të lira.</li> <li>- Ndjekja e miratimit nga Këshilli i Ministrave të projekt vendimit “Për formën dhe mënyrën e raportimit nga ASHK”</li> <li>- Ndjekja e miratimit nga Këshilli i Ministrave të projekt vendimit “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”</li> </ul>	<p>Janar- Mars 2025</p> <p>Janar - Mars 2025</p> <p>Janar- Mars 2025</p>	<p>-Udhëzimet e miratuara dhe publikuar në fletore zyrtare</p> <p>- VKM e miratuar dhe publikuar në fletore zyrtare</p>	Spektori Juridik

2.	Përgatitja e praktikave cilësore të vlerësimit nga komisioni për shqyrtimin e masave administrative.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shqyrtim rigoroz i dokumentacionit dhe materialeve të përcjella nga Grupi i Inspektimit.</li> <li>- Argumentim cilësor i kuadrit ligjor në praktikat administrative në shqyrtim.</li> <li>- Konsolidim dhe unifikim i vendimmarrjes të praktikave administrative të AIF.</li> </ul>	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i vendimeve të pa-ankimuara në Gjykatë sipas propozimit të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative.</li> </ul>	Sektori Juridik
3.	Ndjekja e procedurave gjyqësore pranë gjykatave të të gjitha niveleve për çështjet ku AIF është palë në proces.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja, mbledhja dhe dërgimi i provave për mbrojtjen e çështjes në gjykatë.</li> <li>- Përgatitja e prapësimeve dhe mbrojtjes sa më cilësore për përfaqësimin në gjykatë.</li> </ul>	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	Numri i vendimeve gjyqësore ku vendimmarrja është në favor të AIF.	Sektori Juridik
4.	Ndjekja e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm të masave administrative.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit nga gjykata.</li> <li>- Komunikim me debitorët për ekzekutimin vullnetar.</li> <li>- Kërkesa periodike ndaj Zyrave të Përmbarrimit në nivel qendror dhe vendor.</li> </ul>	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)  Mbi baza gjashtëmuajore	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i kërkesave të dërguara.</li> <li>- Vlera e arkëtuar nga debitorët</li> </ul>	Sektori i Juridik
5.	Kthim përgjigje për institucionet ligj zbatuese në përputhje me afatet dhe normat ligjore.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shqyrtimi dhe hartimi i kthim përgjigjeve në përputhje me normat ligjore.</li> <li>- Respektimi rigoroz i afateve ligjore për kthim përgjigjet.</li> </ul>	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri dhe shpejtësia e shkresave kthim përgjigje.</li> <li>- Shkresa të pa-ankimuara nga kërkuesit (për mos dhënie të informacionit të kërkuar apo shkelje të afateve ligjore).</li> </ul>	Sektori i Juridik
6.	Koordinimi dhe ndjekja e zbatimit të detyrave të lëna nga KBLKPP:  - “Ndjekja e Planit të veprimit të vitit 2024 të miratuar nga	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizimi dhe koordinimi i mbledhjeve të GTNP.</li> <li>- Ndjekja e monitorimit të zbatimit të “Strategjisë Kombëtare PPP/FT”.</li> <li>- Realizimi i ushtrimeve simuluese IO1-4-5-9</li> </ul>	Mbi baza 3 mujore	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i shkresave/email-eve sqaruese/konfirmuese të dërguara.</li> <li>- Numri i takimeve/grupeve të punës të ngritura.</li> <li>- Dokument informues mbi zbatimin e masave</li> </ul>	Sektori i Koordinimit Institucional  - Sektorit të Marrëdhënies

	Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KKBLPP) nëpërmjet koordinimit të institucioneve dhe detyrave të lëna gjatë vitit”			të planit të veprimit të Strategjisë kombëtare PPP/FT.  - analizat e ekspertëve mbi vlerësimin e ushtrimeve simuluese IO1-4-5-9	Ndërkombëtare  (mbështetës)  - Sektori Juridik  (mbështetës)
7.	Koordinimin dhe ndjekje me institucionet përgjegjëse Shqiptare për përgatitjen dhe koordinimin për raundin e 6të të vlerësimit.	- Koordinimi me institucionet në kuadër të plotësimit të pyetësorëve dhe mbledhjes së kontributeve.  - Rishikimi/plotësimi/përpunimi i kontributit dhe kthim përgjigjet nga institucionet.  - Përgatitja e informacioneve në kuadër të informimit të DP, strukturave të tjera hierarkike në vend për ecurinë e zbatimit të vlerësimit nga raundi i 6shtë i Moneyval.	Gjatë gjithë vitit 2025	- Numri i shkresave/email-eve sqaruese/konfirmuese të dërguara.  - Numri i pyetësorëve të plotësuar  - Numri i shkresave informuese/kërkesave shtesë për informacion të dërguara.  - Numri i akteve ligjore / nënligjore të miratuara.	Sektorit të Marrëdhënive Ndërkombëtare  Sektorit të Koordinimit Institucional  (mbështetës)
8.	Koordinimi, plotësimi dhe dërgimi brenda afateve të përcaktuara i kërkesave/ pyetësorëve apo projekteve të dërguar nga Moneyval/Egmont apo organizmave të tjerë ndërkombëtar.	- Koordinim me institucionet përgjegjëse për kërkesave/ pyetësorëve apo projekteve të dërguar.  - Finalizim i materialeve të dërguara për plotësim.  - Respektim i afateve të përcaktuara për dërgimin e materialeve të kërkuara.	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	- Numri i shkresave/email të dërguara.  - Numri i kërkesave/ pyetësorëve apo projekteve të plotësuara.  - Numri i email të dërguara brenda afateve të përcaktuara.	Sektorit të Marrëdhënive Ndërkombëtare  Sektorit të Koordinimit Institucional  (mbështetës)
9	Përgatitja, pjesëmarrja dhe prezantimi në takimet bilaterale në kuadër të kapitujve që AIF është anëtare (kryesisht Kapitulli 4, 23, 24 dhe 31).	- Koordinim me institucionet përgjegjëse për takimet bilaterale.  - Plotësimi i prezantimeve në koordinim edhe me strukturat e tjera brenda AIF.  - Respektim i afateve të përcaktuara për dërgimin e materialeve të kërkuara dhe	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	- Numri i takimeve që merret pjesë.  - Prezantimet e përgatitura për tu paraqitur.  - Numri i takimeve bilaterale ku merret pjesë.	Sektorit të Marrëdhënive Ndërkombëtare

		marrja pjesë në takimet bilaterale.			Sektorit të Koordinimit Institucional  Sektori Juridik (mbështetës)
10.	Organizimi i mbledhjeve të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) dhe asistimit në përgatitjen e materialeve në kuadër të raportimit të AIF.  Minimalisht 2 takime në vit.	- Koordinimi me anëtarët e komitetit për organizimin e takimit;  - Hartimi i materialeve informuese, agjendës dhe vënia në dispozicion për anëtarët e Komitetit.	Qershor 2025  Dhjetor 2025	- Numri i email të dërguar;  - Dokumentet e hartuara (draft axhendë dhe materialet për raportim)  - Mbajtja e takimit të KBLKPP.	Sektorit të Koordinimit Institucional  Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare (mbështetës)  Sektori Juridik (mbështetës)
11.	Rritja e cilësisë dhe efektivitetit në kthimin e përgjigjeve për institucionet ligj zbatuese Shqiptare, organizmat ndërkombëtare dhe Njësitë homologe të Inteligjencës Financiare.	- Kërkimi në DB dhe burimet e tjera të informacionit në dispozicion të AIF.  - Komunikimi me sektorët e Drejtorisë së Analizës apo institucione të tjera sipas rastit në funksion të draftimit të përgjigjeve.  - Respektimi i afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve.	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	- Numri i kthim përgjigjeve sipas institucioneve ligj zbatuese. - Numri i kthim përgjigjeve për njësitë homologe;  - Numri i kthim përgjigjeve për organizatat ndërkombëtare.	Sektorit të Koordinimit Institucional  Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare (mbështetës)  Sektori Juridik (mbështetës)
12.	Ndjekja e zhvillimeve të Grupit EGMONT, Komitetit MONEYVAL të KE dhe praktikave më të mira të FATF.	- Administrimi i rrjetit të shpërndarjes së informacionit me njësitë homologe (shpërndarja dhe dërgimi i kërkesave/përgjigjeve/informacioneve spontane nga/drejt sektorëve të Analizës/Marrëdhënieve me Jashtë drejt/nga njësitë homologe).  - Informimi i stafit të Drejtorisë me zhvillimet e fundit të Grupit Egmont, praktikave më të mira të FATF.	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	- Numri i email të dërguar.  - Numri i korrespondencës të shpërndarë.  - Numri i kthim përgjigjeve/kërkesave.	Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare



13.	Mbarëvajtja e korrespondencës elektronike të AIF me institucionet e tjera ligj zbatuese, palët e treta dhe publikun.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Menaxhimi i adresës zyrtare të AIF (shpërndarje dhe qarkullim i informacionit për Drejtoritë e tjera brenda AIF).</li> <li>- Përgatitja e kthim përgjigjeve për pjesën e kompetencës të DKJ.</li> </ul>	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i email të dërguar.</li> <li>- Numri i korrespondencës të shpërndarë.</li> <li>- Numri i kthim përgjigjeve/kërkesave.</li> </ul>	Sektorit të Koordinimit Institucional  Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare  (mbështetës)  Sektori Juridik (mbështetës)
14.	Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të DKJ nëpërmjet ndjekjes së takimeve të punës/ trajnimeve/ aktiviteteve/ konferencave sipas fushës së veprimtarisë si brenda dhe jashtë vendit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga ASPA.</li> <li>- Pjesëmarrje në takime/ aktivitete/ konferenca/ trajnime me ftesë të bashkëpunëtorëve si brenda dhe jashtë vendit.</li> </ul>	Gjatë vitit  (Janar – Dhjetor 2025)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i trajnimeve/ takimeve/ aktiviteteve/ konferencave që stafi i DKJ ka marrë pjesë;</li> <li>- Numri i stafit të përfshirë;</li> <li>- Dokumente/ prezantime të shpërndara.</li> <li>- Memo të përgatitura.</li> </ul>	Sektorit të Koordinimit Institucional  Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare  Sektori Juridik
15	Monitorimi i “Strategjisë Kombëtare PPP/FT” dhe raportimi i masave të parashikuara në planin e veprimit 2024-2027	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Koordinim me institucionet përgjegjëse për zbatimin e strategjisë kombëtare.</li> <li>- Respektim i afateve të përcaktuara në planin e veprimit.</li> <li>- Realizmi i takimeve me institucionet përgjegjëse.</li> </ul>	Gjatë vitit  Mbi baza 4 mujore  (Janar – Dhjetor 2025)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i email të dërguar.</li> <li>- Numri i korrespondencës të shpërndarë.</li> <li>- Numri i kthim përgjigjeve/kërkesave .</li> <li>- Numëri i informacioneve të përgatitura.</li> <li>- Numri i takimeve të realizuara.</li> <li>- Numri i raporteve të përgatitura.</li> </ul>	Sektorit të Koordinimit Institucional  Sektorit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare  (mbështetës)  Sektori Juridik (mbështetës)